



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

01 _ Nr. 16-27781/12.
Kaçanik, 30.10.2012.



Komuna e Kaçanikut
Opstina Kacanik
Municipal Kacanik

PLAN I VEPRIMIT

Të gjeturat	Veprimet e kërkuara	Përgjegjës	Asistanca	Afati kohor
1. Duhet të vendoset një sistem automatik për të gjitha llojet e taksave, duhet të bëhen barazimet në mes zyrtarit të të hyrave dhe departamenteve operationale dhe duhet të merren masa për të shtuar mbledhjen e të hyrave nga taksat e ndryshme,	Rekomandimi - 1. Që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrollin të sigurt, eficient dhe efektiv në faturim dhe të hyra.	Kryetari i komunës Drejtori i Financave Të gjithë drejtorët tjerë që krijojnë të hyra	MF -Sigurimin e një shtuuesi unik në nivel vendit; Zyra Kryesore Komunale për evidentimin e THVK	TM-1, 2013
2. Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për përmirësuar procesin e shpenzimeve	Rekomandimi - 2. Që Kryetari të sigurohet që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtejshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzim. dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve komunale	Kryetari i komunës Zyra e Prokurimit	Ligji nr.04/L-042 - Për Prokurim Publik	Viti 2012
3. Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të paguar të gjitha faturat e papaguara brenda afatave kohore; Rregullorja mbi menaxhimin e Parave të Gatshme të Organizatave Buxhetore duhet të ndiqet në mënyrë të përpiktë;	Rekomandimi - 3. Që Kryetari të vendos një proces i cili siguron që të arkëtueshmet janë regjistruar sapo të jetë bërë faturimi,..... Rishikimi i trajtimit të limitit të pranimit të PG	Kryetari i komunës Drejtori i Financave	Zbatimi i përpiktë i Ligjit nr.03/L-048 - Për MFPP dhe Ndryshimet me Ligjin nr.03/L-221.	TM-4,2012

4. Pasuritë kapitale dhe Jo kapitale, vlerësimi nga komisioni i brendshëm e jo nga vlerësuesit e certifikuar,	Rekomandimi - 4. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe të certifikuar si praktikë më e mirë në rastet e tilla. Komuna duhet të ketë parasysh një analizë të kostos krahasuar me benefitet e përfshirjes së ekspertëve vlerësues përpara se t'i angazhoj ata.	Kryetari i komunës Drejtori i Financave	Qeveria dhe MF	TM-1, 2013
5. Komuna nuk ka një proces adekuat të identifikimit, evidencimit dhe përcelljës të faturave të papaguara. Kjo mund të çojë në shpalosje jo të rregullta të faturave të papaguara.	Rekomandimi - 5. Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtijshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.	Kryetari i komunës Drejtori i Financave Të gjithë drejtorët tjerë që krijojnë të hyra	Zbatimi i përpikët i Ligjit nr.03/L-048 - Për MFPP (neni 39.1.)	TM-4,2012
6. Mungesa e Pagesave nga Palët e Treta në SIMFK, kur dihet se PF janë informacione parësore	Rekomandimi - 6. Kryetari i Komunës për përgatitjen e PF duhet të sigurohet që informacionet e kërkuara janë regjistruar, procesuar përmbledhur dhe raportuar drejt.	Kryetari i komunës Drejtori i Financave	MF - Për përfshirjen obligative të Palëve të Treta në SIMFK	Viti 2013

KONKLUZIONET E PËRGJITHSHME :

Sipas raportit të auditimit është kërkuar përmirësimet duhet të bëhen në fushat e të hyrave, të prokurimit, paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj, trajtimi i të arkëtueshmeve, pagimi i detyrimeve brenda afatit të kërkuar dhe vlerësimi i pasurive kapitale dhe jokapitale.

Rekomandimi i përgjithshëm:

- Duhet të vendoset një sistem automatik i faturimit për të gjitha llojet e taksave, duhet të bëhen barazimet në mes zyrtarit të të hyrave dhe departamenteve operacionale dhe duhet të merren masa për të shtuar mbledhjen e të hyrave nga taksat e ndryshme;
- Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të përmirësuar procesin e shpenzimeve;
- Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të paguar të gjitha faturat e papaguara brenda afateve kohore;
- Rregullorja mbi menaxhimin e parave të gatshme të organizatave buxhetore duhet të ndiqet në mënyrë të përpiktë;

Fikri Vërbani,
Drejtor i DEFZH-së

Besim Ilazi,
Kryetar i Komunës